

Në pajtim me Vendimin për përcaktim të lokaliteteve për vendosjen e pajisjeve urbane – objekte të lëvizshme, aparate të lëvizshme dhe vegla të tjera në Parkun e qytetit në Shkup (“Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” nr. 8/19), Kryetari i Qytetit të Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE
për shfaqjen e interesit për shfrytëzimin e lokaliteteve për vendosjen e
pajisjeve urbane në Parkun e qytetit

1. Lënda

Lënda e thirrjes publike është shfaqja e interesit për shfrytëzimin e lokaliteteve për vendosjen e pajisjeve urbane – objekteve të lëvizshme, aparateve të lëvizshme dhe veglave të tjera.

Pajisja urbane do të vendoset në 21 lokalitete në Parkun e qytetit. Lokalitetet janë të përcaktuara në shtojcën grafike që është pjesë përbërëse e vendimit për përcaktimin e lokaliteteve për vendosjen e pajisjeve urbane – objekteve të lëvizshme, aparateve të lëvizshme dhe pajisjeve të tjera në Parkun e qytetit Shkup.

Me objekte të lëvizshme nënkuptohen objektet që janë me motor për lëvizje të pavarur ose rimorkio që nuk posedon motor për lëvizje, përkatësisht automjetet e specializuara për shitje në rrugë, me gjatësi prej deri më 4 metra dhe me lartësi deri më 3 metra në të cilat mund të ofrohen shërbime të konfeksionuara hotelerike që nuk kanë ndikime negative ekologjike mbi mjedisin (shfrytëzojnë agregate për furnizimin me energji elektrike, janë me zhurmë të ulët, posedojnë agregate me cilësi të lartë, nuk posedojnë agregate industriale dhe posedojnë certifikatën se posedojnë emetime të ulëta të gazrave të dëmshëm).

Sipërfaqja maksimale e lokalitetit në të cilin vendoset pajisja urbane është deri më 16 m², në të cilën është e përfshirë objekti i lëvizshëm, përkatësisht aparati i lëvizshëm ose veglat tjera, hapësira për manipulime, pajisa urbane në funksion të shfrytëzimit të lokalitetit – shporta për mbeturina dhe agregati.

2. Kushtet

1. Pajisja urbane – objektet e lëvizshme, aparatet e lëvizshme dhe veglat tjera, e vendosur në lokalitet të përcaktuar, mund të shfrytëzohet vetëm për shitjen e akullores (frigoriferët për akullore), pije, prodhime konditore, përgatitjen e kokoshkave, pambuk sheqeri, petulla të ëmbla dhe etj.
2. Objektet e vendosura, aparatet e lëvizshme dhe veglat nuk duhet të përmbajnë zërime dhe sisteme të ngjashme për lëshimin e muzikës.
3. Në pajisjet urbane mund të vendosen mbishkrime reklamuese të cilat nuk janë më të mëdha se dimensionet e pjesës së parme të objektit në të cilin

vendosen dhe me dimensionet e tij (lartësia dhe gjerësia) janë pjesë përbërëse e objektit.

4. Subjekti i përzgjedhur është i detyruar që të paguaj taksën komunale në pajtim me dispozitat në fuqi.
5. Aplikuesi duhet të posedojë vendbanimin në territorin e Qytetit të Shkupit (komunat: Aerodrom, Gazi Babë, Kisella Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizare, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj).

3. Korniza kohore

1. Lokalitetet në të cilat janë të vendosura pajisjet urbane – objektet e lëvizshme dhe veglat tjera jepen në shfrytëzim për periudhën nga 1 marsi deri më 30 nëntor të vitit në rrjedhë.

4. Kushtet

1. Kërkuesi është i detyruar që ti përmbush këto kushte:
6. Pajisja urbane – objektet e lëvizshme, aparatet e lëvizshme dhe veglat tjera në lokalitetin e përcaktuar, mund të shfrytëzohen mund të shfrytëzohet vetëm për shitjen e akullores (frigoriferët për akullore), pije, prodhime konditore, përgatitjen e kokoshkave, pambuk sheqerit dhe petullat e ëmbla.
 - Në lokalitetet në Parkut e qytetit mund të vendosen objektet e lëvizshme, aparate dhe vegla të tjera që posedojnë dizajn dhe pamje e cila nuk e cenon mjedisin e rrethit ku janë të vendosura.
 - Sipërfaqja maksimale e lokalitetit në të cilin vendoset pajisja urbane – objektet e lëvizshme, aparatet e lëvizshme dhe veglat tjera është deri më 16 m², në të cilën është e përfshirë objekti i lëvizshëm, përkatësisht aparati i lëvizshëm ose veglat tjera, hapësira për manipulime, pajisja urbane në funksion të shfrytëzimit të lokalitetit – shporta për mbeturina dhe agregati.
7. Për vendosjen e pajisjeve urbane, subjekti i përzgjedhur është i detyruar që të paguaj taksën komunale në pajtim me dispozitat në fuqi.

5. Procedura

1. Të drejtën e pjesëmarrjes në thirrjen publike e kanë të gjithë personat juridik të interesuar për shfrytëzimin e lokalitetit në Parkun e qytetit – pjesa e parë dhe e dytë për vendosjen e pajisjeve urbane – objekte të lëvizshme, aparatet të lëvizshme dhe vegla të tjera për shitjen e

akulloreve, pijeve dhe prodhimeve të tjera, përgatitjen e kokoshkave, pambuk sheqerit dhe petullave të ëmbla.

2. Së bashku me kërkesën për shfrytëzimin e lokalitetit për vendosjen e objektit të lëvizshëm, duhet të dorëzohet:

- Fotokopja e letërnjoftimit të vlefshëm si dëshmi se personi është banorë i qytetit të Shkupit.
- Deklaratën për pagesën e shumës monetare për mbulimin e shpenzimeve për rregullimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqes publike që shfrytëzohet për vendosjen e objektit të lëvizshëm për periudhën nga 1 marsi deri më 30 nëntor të vitit në rrydhë.
- Dëshminë për posedimin e aparatit fiskal.
- Dëshmi për veprimtarinë e regjistruar nga Regjistri Qendrorë i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Shtojcën grafike – skicën me dimensione të sakta të objektit të lëvizshëm, dhe
- Lokalitetin e kërkuar si dhe pamjen e pajisjes urbane e cila vendoset.

3. Pas marrjes së lejes për vendosjen e pajisjes urbane – objekteve të lëvizshme, të lidhet kontrata me NP “Higjiena komunale” dhe të dorëzohet Aktvendimi për regjistrimin e objektit të lëvizshëm, i dhënë nga Agjencia për ushqime dhe veterinë në afatin prej 7 ditëve nga dita e pranimit të lejes.

4. Subjekteve të interesuara të cilat plotësojnë kushtet nga pika II do t’u lejohet shfrytëzimi i lokacionit për vendosjen e objekteve të luajtshme në përputhje me parimin “I pari i ardhur, i pari shërbehet”;

5. Nëse subjekti kërkon që t’i miratohet lokacioni për vendosjen e objektit të luajtshëm, para 1 marsit, dhe pas 30 nëntorit, në përputhje me Vendimin për rregullin komunal mundet përkohësisht (gjatë kohës së mbajtjes së manifestimeve) të marrë leje.

6. Afati për dorëzimin e aplikimeve është 10 ditë nga dita e shpalljes së thirrjes publike në gazetata ditore.

7. Kërkesa, deklarata dhe paraqitja grafike mund të merren në Arkivin e Qytetit të Shkupit dhe barakën numër 11, zyra numër 1, bul. Ilinden nr. 82, 1000 Shkup

8. Lokacionet për vendosjen e pajisjeve urbane do të vendosen në koordinata, në portalin zyrtar të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

Pika	x	y
1-pije	7.535.438,933	4.651.128,334
2- pije	7.535.458,426	4.651.155,851
*3-pije dhe/ose ushqim	7.535.480,877	4.651.186,702
4- pije	7.535.503,689	4.651.213,554
5-kokoshka	7.535.407,502	4.651.281,065
6- kokoshka	7.535.514,643	4.651.285,140
7-pije	7.535.448,998	4.651.330,250
*8-petulla dhe/ose akulllore	7.535.423,516	4.651.358,437
9- pije	7.535.268,170	4.651.289,173
10- pije	7.535.228,639	4.651.398,448
*11-petulla dhe/ose akulllore	7.535.290,289	4.651.475,529
*12-ushqim dhe/ose pije	7.535.323,646	4.651.529,673
*13-pambuk sheqeri dhe/ose pije	7.535.273,561	4.651.573,260
14-pije	7.535.246,256	4.651.594,330
15-akulllore	7.535.196,912	4.651.616,360
16-pije	7.535.353,723	4.651.744,336
17- pije	7.534.988,024	4.651.712,453
*18-ushqim dhe/ose pije	7.534.814,069	4.651.713,774
*19-ushqim dhe/ose pije	7.534.848,201	4.651.894,552
20-ushqim dhe/ose pije	7.534.657,079	4.651.778,668
21-pije	7.535.513,606	4.651.049,540
Koordinatat janë në Sistemin e koordinatave shtetërore të Maqedonisë		

*Për lokacionet me dhe/ose, mund të aplikohet për të gjitha ose për 1 ose më shumë nga të lartpërmendurat

*Aplikuesi mund të dorëzojë kërkesë për më së shumti 3 lokacione, ndërsa në rast se nuk i shfrytëzon, Komisioni vendos për marrjen e Lejes

*Leja mund të anulohet nëse aplikuesi nuk depoziton dokumentet nga kreu 5 pika 3

9. Kërkesa me dokumentacionin e plotë nga pika 9 duhet të dorëzohet nëpërmjet Arkivit të Qytetit të Shkupit, pranë Sektorit për punë komunale, me shënimin - Thirrje publike për vendosjen e pajisjeve urbane - objekte të luajtshme, aparate të luajtshme dhe pajisje të tjera në Parkun e qytetit – Shkup

10. Ngarkohet kryetari i Qytetit të Shkupit të formojë Komisionin për zbatimin e Thirrjes publike

11. Subjektet e interesuara që marrin pjesë në thirrjen publike do të njoftohen për rezultatet e procedurës së realizuar më së shumti deri në 10 ditë nga dita e skadimit të afatit për dorëzimin e aplikimeve.

*Arkivi i Qytetit të Shkupit gjendet në adresën bul. Ilinden nr.82, 1000 Shkup

Kontakt: Sektori për punën komunale
тел: 02/3297-389

QYTETI I SHKUPIT
KRYETARI I QYTETIT TË SHKUPIT